

LIGJ¹
Nr. 60/2023

**PËR TRAJTIMIN E VEÇANTË TË STUDENTËVE QË NDJEKIN PROGRAMIN
E INTEGRUAR TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “MJEKËSI E
PËRGJITHSHME” NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË**

*(Ndryshuar me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 1, datë 25.1.2024²; me ligjin nr. 102/2024, datë
19.9.2024)*

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Objekti

(Shtuar togfjalësh me ligjin nr. 102/2024, datë 19.9.2024)

Ky ligj përcakton rregulla të veçanta për trajtimin e studentëve shtetas shqiptarë që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë.

Neni 2

Qëllimi

Ky ligj synon sigurimin e burimeve njerëzore për kryerjen e shërbimeve të shëndetit publik në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet përcaktimit të rregullave për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë.

Neni 3

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

1. “Trajtimi i veçantë” përfshin punësimin me prioritet të studentit që ndjek programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë, si dhe përfitimin nga programet sociale të strehimit.

2. “Punësim me prioritet” është nisma për t’i dhënë përparësi punësimit në institucionet e shërbimit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë të studentëve që diplomohen në këtë program studimi dhe kanë nënshkruar marrëveshjen sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 4

Kategoritë përfituese të trajtimit të veçantë

¹ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 1 (Nj) 2023, datë 14.11.2023, botuar në FZ. nr. 171, datë 22.11.2023 në pikën 1 shprehet:

“1. Pranimin e kërkesës për **pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 60/2023**, “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë ‘Mjekësi e Përgjithshme’ në institucionet publike të arsimit të lartë.”

² Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.1, datë 25.1.2024, botuar në FZ. nr. 40, datë 4.3.2024, në pikën 5 shprehet:

“5. **Heqjen e masës së pezullimit të zbatimit të ligjit nr. 60/2023**, “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë ‘Mjekësi e Përgjithshme’ në institucionet publike të arsimit të lartë.”

(Shfuqizuar togfjalështa në shkronjat “a”, “b”, “c” të pikës 1, në shkronjat “a”, “b” të pikës 2 dhe në shkronjat “a”, “b” të pikës 3 me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 1, datë 25.1.2024; ndryshuar togfjalështa në shkronjat “a”, “b”, “c” të pikës 1, në shkronjat “a”, “b” të pikës 2 dhe në shkronjat “a”, “b” të pikës 3 me ligjin nr. 102/2024, datë 19.9.2024)

1. Trajtim të veçantë përfiton kandidati që pranohet në programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë kur plotëson kushtet si më poshtë:

a) plotëson deklaratën për përmbushjen e kushteve, parashikuar në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni, përpara zhvillimit të testimit të detyruar për pranimin në këtë program studimi;

b) nënshkruan marrëveshje para regjistrimit të tij si fitues në këtë program, e cila lidhet ndërmjet tij, ministrisë përgjegjëse për arsimin, ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionit të arsimit të lartë publik për të punuar në profesionin e mjekut pas përfundimit të studimeve për jo më pak se 3 (tre) vjet në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë;

c) pranon kalimin zyrtarisht të diplomës përkatëse të arsimit të lartë nga institucioni publik i arsimit të lartë, ku ka përfunduar studimet, në institucionin shëndetësor ku punësohet deri në shlyerjen e detyrimeve për punësim sipas afatit 3-vjeçar, me të drejtën që pas përmbushjes së detyrimit të punësimit të tërheqë diplomën universitare.

2. Trajtim të veçantë përfiton studenti i vitit të dytë deri në vitin e katërt akademik kur pranon përmbushjen e kushteve si më poshtë:

a) nënshkruan marrëveshje para fillimit të vitit akademik përkatës dhe për të gjithë periudhën e kohëzgjatjes së studimeve, e cila lidhet ndërmjet tij, ministrisë përgjegjëse për arsimin, ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionit të arsimit të lartë publik për të punuar në profesionin e mjekut pas përfundimit të studimeve për jo më pak se 2 (dy) vjet në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë;

b) pranon kalimin zyrtarisht të diplomës përkatëse të arsimit të lartë nga institucioni publik i arsimit të lartë, ku ka përfunduar studimet, në institucionin shëndetësor ku punësohet deri në shlyerjen e detyrimeve për punësim sipas afatit 2-vjeçar, me të drejtën që pas përmbushjes së detyrimit të punësimit kandidati të tërheqë diplomën universitare.

3. Trajtim të veçantë përfiton studenti i vitit të pestë ose të gjashtë në këtë program kur pranon përmbushjen e kushteve si më poshtë:

a) nënshkruan marrëveshje para fillimit të vitit akademik përkatës dhe për të gjithë periudhën e kohëzgjatjes së studimeve, e cila lidhet ndërmjet tij, ministrisë përgjegjëse për arsimin, ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionit të arsimit të lartë publik për të punuar në profesionin e mjekut pas përfundimit të studimeve për jo më pak se 1 (një) vit në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë;

b) pranon kalimin zyrtarisht të diplomës përkatëse të arsimit të lartë nga institucioni publik i arsimit të lartë, ku ka përfunduar studimet, në institucionin shëndetësor ku punësohet deri në shlyerjen e detyrimeve për punësim sipas afatit 1-vjeçar, me të drejtën që pas përmbushjes së detyrimit të punësimit kandidati të tërheqë diplomën universitare.

Neni 5

Pagesa e vlerës së plotë të kostos së studimeve

Studenti që nuk pranon të nënshkruajë marrëveshje për të punuar në një institucion shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, publik ose privat, nga data e lindjes të së drejtës për punësim me ministrinë përgjegjëse për arsimin, ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionin e arsimit të lartë publik sipas përcaktimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 4 të këtij ligji, paguan vlerën e plotë të kostos së studimeve. Metodologjia për përcaktimin e kostos së studimeve për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë dhe çdo mbështetje tjetër për studentët e këtij programi studimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Punësimi

(Ndryshuar me ligjin nr. 102/2024, datë 19.9.2024)

1. Për studentin që përfundon programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë dhe ka nënshkruar marrëveshje sipas përcaktimeve të këtij ligji, në momentin e lindjes së të drejtës për punësimin e tij ndiqen procedurat e mëposhtme:

a) punësohet në institucionet shëndetësore sipas nevojave për mjekë të shpallura nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe përzgjedhja e vendeve të punës bëhet nga mjeku i licencuar në bazë të renditjes sipas notës mesatare të përfundimit të studimeve;

b) koha e kryerjes së procedurës për punësimin e mjekut nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë është brenda 3 (tre) muajve nga momenti i lindjes së të drejtës për punësim.

2. Në rastet kur punësimi nuk realizohet brenda 3 (tre) muajve për shkaqe që nuk varen nga mjeku, deri në krijimin e mundësisë për punësim në institucionet shëndetësore publike, për një periudhë deri në 9 (nëntë) muaj, mjeku i lind e drejta të trajtohet me 80% të pagës së mjekut të përgjithshëm në kujdesin parësor për një periudhë jo më të gjatë se ky afat, ose të zgjedhë të punësohet në institucionet shëndetësore jo publike në vend, duke njoftuar ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, si dhe duke ruajtur të drejtën për punësim prioritar brenda periudhës 9-mujore (nëntëmujore) në institucionet shëndetësore publike.

3. Periudhat sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni përfshihen brenda afateve të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji kur mjeku punësohet, në rast të kundërt, pas përfundimit të tyre, konsiderohet i përmbushur detyrimi sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe mjeku ka të drejtën të pajiset me diplomën përkatëse universitare.

4. Mënyra dhe procedura e punësimit me prioritet përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

Neni 7

Përfitime nga trajtimi i veçantë

Studenti që ka nënshkruar marrëveshje sipas përcaktimeve të këtij ligji, ka përparësi në përfshirjen në programet sociale të strehimit.

Masa e subvencionimit të interesave të kredisë për strehim llogaritet si diferencë midis interesit të dakordësuar me institucionet financiare dhe interesit që paguan studenti sipas legjislacionit në fuqi për strehimin social.

Neni 8

Periudha e studimeve në specializimet afatgjata në mjekësi

Në rast të ndjekjes së studimeve në specializimet afatgjata në mjekësi në institucionet publike të arsimit të lartë, periudha e ndjekjes së këtyre studimeve konsiderohet si periudhë punësimi në rast se studentët përfshihen në kuotat e pambuluara.

Studentët e kuotave të mbuluara në specializimet afatgjata në mjekësi respektojnë detyrimet sipas marrëveshjes përkatëse të nënshkruar me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe periudha e punësimit në Shqipëri konsiderohet detyrim i përmbushur.

Neni 9

Dispozitë kalimtare

(Ndryshuar me ligjin nr. 102/2024, datë 19.9.2024)

Ky ligj i shtrin efektet në periudhën nga viti akademik 2025-2026 deri në vitin akademik 2029–2030.

Neni 10

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për miratimin e aktit nënligjor në zbatim të nenit 5 të këtij ligji brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.
2. Ngarkohen ministri përgjegjës për arsimin dhe ministri përgjegjës për shëndetësinë që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrin udhëzimin e përcaktuar në nenin 6 të këtij ligji.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 21.7.2023